

# Akt-Themelimi

## Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA”

Në bazë të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” **prej me datë 02.09.2008 me si anëtarë:**

**Iljaz Spahiu** i biri Emriut, i datëlindjes 05.07.1969, banues në Tiranë, me adresë Rruga “Mujo Ulqinaku” Pallati “Teknoprojekt”, Shkalla 2 Apartamenti 4 Tiranë.

**Andi Kume** i biri Thimjos, i datëlindjes 11.12.1983, banues në Tiranë, me adresë Rruga “Dora D’Istra” Pallati 12/1, Shkalla 1, Apartamenti 4.

**Xhezmi Kadi** i biri Safetit, i datëlindjes 16.08.1959, banues në Tiranë, me adresë Rruga “Samu Frashëri” Pallati 20/1, Shkalla 2, Apartamenti 16.

**Themelojnë Shoqërinë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” dhe kërkojnë regjistrimin e saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.**

### Hyrje

Qëllimi i këtij akti është themelimi i Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA”.

#### 1-Forma

**Shoqëri tregtare aksionare.**

#### 2-Emërtimi i Shoqërisë

**[GLEAND-OIL]“SHA”.**

#### 3-Objekti

Shoqëria Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” ka për objekt veprimtarie:

\*Import, eksport, tregtim me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre\*.

#### 4-Aksionarët Themelues

Shoqëria Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” themelohet nga aksionarët:

**Iljaz Spahiu** i biri Emriut dhe i Bahrijes, i datëlindjes 05.07.1969, me vendlindje Kukës, nënshetetas shqiptar, banues në Tiranë, me adresë Rruga “Mujo Ulqinaku” Pallati “Teknoprojekt”, Shkalla 2, Apartamenti 4.

**Andi Kume** i biri Thimjos dhe Vasilukes, i datëlindjes 11.12.1983, me vendlindje Tiranë, nënshetetas shqiptar, banues në Tiranë, me adresë Rruga “Dora D’Istra” Pallati 12/1, Shkalla 1, Apartamenti 4.

**Xhezmi Kadi** i biri Safetit dhe i Mines, i datëlindjes 16.08.1959, me vendlindje Korçë, nënshetetas shqiptar, banues në Tiranë, me adresë Rruga “Samu Frashëri” Pallati 20/1, Shkalla 2a Apartamenti 16.

Aksionarët kanë të drejta dhe detyrime që lindin sipas legjislacionit shqiptarë në fuqi nga veprimtaria e Shoqëria [GLEAND-OIL]“SHA” nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### 5-Administrator

Administrator i Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” emërohet për 3(tre) vjet me të drejtë nemërimi **z. ILJAZ SPAHIU**, i biri i Emriut, dhe i Bahrijes, nënshetetas shqiptar, i datëlindjes 05.07.1969, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, i cili përfaqëson shoqërinë përpara të tretëve dhe ushtron funksionet për sa është parashikuar në nenin 15-21 të këtij Statuti si dhe sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### 6-Selia

Shoqëria Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” do të ketë Selinë në këtë adresë: Qarku Tiranë, Bashkia Kamez, Valias i Ri nr.6.

#### 7-Organe drejtuese të Shoqërisë

Organet drejtuese të Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” janë në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” me strukturë si vijon:

- 1-Asambleja e Përgjithshme.
- 2-Këshilli Mbikëqyrës.
- 3-Administratori.

Organizimi i secilit organ, përbërja, zgjedhja dhe funksionimi i tyre përshkruhet hollësisht në Statutin e Shoqërisë.

Afati për mandatin e parë të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, Administratorit dhe Ekspertit Kontabël fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### 8-Kapitali Themeltar i Shoqërisë

Shoqëria Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” ka si Kapitali bazë të themelimit të shumën prej 2.000.000 (dy milion)Lekë.

Shoqëria Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” ka nënshkruar 100 (njëqind) aksione në formë nominale të zakonshme.

Vlera nominale e një aksioni të zakonshëm është 20.000(njëzetmijë)Lekë.

Numri i aksioneve të Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” të nënshkruara nga aksionari Iljaz Spahiu është 34 (tridhjetë e katër).

Numri i aksioneve të Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” të nënshkruara nga aksionari Andi Kume është 33 (tridhjetë e tre).

Numri i aksioneve të Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” të nënshkruara nga aksionari Xhezmi Kadi 33 (tridhjetë e tre).

Vlera kontributit e cila është paguar nga aksionari Iljaz Spahiu në Shoqërinë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” është 680.000 (gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.

Vlera kontributit e cila është paguar nga aksionari Andi Kume në Shoqërinë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” është 660.000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë.

Vlera kontributit e cila është paguar nga aksionari Xhezmi Kadi në Shoqërinë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” është 660.000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë.

Kapitali themeltar i cili është nënshkruar nga aksionaret likuidohet plotësisht në momentin e nënshkrimit të Statutit.

Aksionarët janë përgjegjës ndaj Shoqërisë [GLEAND-OIL]“SHA” për të gjitha detyrimet ndaj të tretëve deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin themeltar.

#### 9-Kohëzgjatja

Shoqëria Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” themelohet për të ushtruar veprimtarinë e saj **për një periudhë 30 (tridhjet) vjet**, me të drejtë nëpërtëritje duke filluar nga koha e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Për shkakë të arsyeshme mund të mbarojë aktiviteti para këtij afati në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi.

#### 10-Administrimi i Shoqërisë

Administrimi i Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” do të realizohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Rregullat për funksionimin dhe drejtimin e shoqërisë janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” që shoqëron këtë Akt-Themelimi.

Të gjitha mosmarrëveshjet me organet shtetërore, personat juridik e fizik vendas apo të huaj, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

#### 11-Eksperti Kontabël i Autorizuar

Ekspert Kontabël i Autorizuar për vitin e parë financiar në Shoqërinë Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA”, emërohet **z.Arif Sanxhaku**, i biri i Muhameti, i datëlindjes 10.08.1942, lindur dhe banues në Durres, i identifikuar me Pasaportë nr.Z1710732, NIPT “K615195020” nr.Licence 09, date 02.02.2006.

Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 dhjetor të po atij viti.

#### 12-Regjistrimi në “QKR”.

Procedurën lidhur me paraqitjen e Kërkesës, Akt-Themelimit dhe Statutit e Shoqërisë Tregtare Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA” në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit do ta ndjek **Av.Ndue Gjoni-Nr.Licence nr.1194-Doma e Avokatisë Tiranë**.

Ky Akt-Themelimi përpilohet në katër kopje, duke patur secila fuqi të plotë ligjore të barabartë, nënshkruhet rregullisht me vullnet të lirë dhe vetëdije të plotë nga aksionarët themelues të Shoqërisë Tregtare Aksionare [GLEAND-OIL]“SHA”

Një kopje depozitohet tek Noteri, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje depozitohet tek Dega e Tatim Taksave, ndërsa kopja tjetër do të qëndrojë në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

#### AKSIONARËT-THEMELUES TË SHOQËRISË [GLEAND-OIL]“SHA”

1-Iljaz SPAHIU 2-Andi KUME 3-Xhezmi KADI

Iljaz Spahiu

Andi Kume

Xhezmi Kadi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERËVE TIRANË

U aplikua pulla

Nr. 0304 Rep.

Nr. 3192 Rep.

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Në Tiranë, sot me datë 02.09.2008 (dymijë e tetë), para meje Noterit Violeta Sulkaj, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me Seli Rr. “Muhamet Gjollësja” Pallati “SCUTARI KONSTRUKSION” Hyrja 1, Tiranë, u paraqitën personalisht shtetasit:

**Iljaz Spahiu** i biri Emriut, i datëlindjes 05.07.1969, banues në Tiranë, i identifikuar prej meje me dokument identifikimi Pasaportë nr.S0001489.

**Andi Kume** i biri Thimjos, i datëlindjes 11.12.1983, banues në Tiranë, i identifikuar prej meje me dokument identifikimi Pasaportë nr.Z1472536.

**Xhezmi Kadi** i biri Safetit, i datëlindjes 16.08.1959, banues në Tiranë, i identifikuar prej meje me dokument identifikimi Pasaportë nr.Z1033917.

Pësonat e cituar më deklaruan se sa me sipër është **AKT-THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE AKSIONARE [GLEAND-OIL]“SHA”** i hartuar dhe redaktuar jashtë kësaj Zyre.

Me vullnetin e tyre të lirë dhe vetëdije të plotë nënshkruan **AKT-THEMELIMI E SHOQËRISË TREGTARE AKSIONARE [GLEAND-OIL]“SHA”** para noterit dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE  
Violeta SULKAJ